



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

# Pulsi Publik XVIII

**Përpiluar nga UNDP në Kosovë – Ekipi i Projektit Pulsi Publik**

Prishtinë/Priština  
*Prill 2020*

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të të anketuarve të anketës dhe nuk i paraqesin domosdoshmërisht as pikëpamjet e UNDP-së e as ato të USAID-it.

Përmbajtja	
Lista e tabelave .....	3
Lista e figurave .....	3
Përmbledhje Ekzekutive.....	4
Treguesit kyç të Pulsit Publik .....	5
Drejtimi politik i Kosovës .....	6
Siguria personale .....	8
Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike .....	9
Drejtimi Ekonomik.....	12
Problemet themelore me të cilat përballet Kosova aktualisht .....	13
Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat .....	15
Korrupsioni në shkallë të gjerë.....	16
Qëndrimet kundrejt votimit.....	19
Mjedisi.....	22
COVID 19.....	25
Metodologjia .....	33
Peshimi i totaleve të popullatës .....	33
Përlllogaritja e Indekseve .....	34

---

## Lista e tabelave

Table 1. Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Table 2. Analiza e trendeve të komponenteve të ID-së .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Table 3. Analiza e trendeve të komponenteve të IBE-së .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Table 4. Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Lista e figurave

Figura 1. Përqindja e të anketuarve që do të merrnin pjesë në protesta politike.....	8
Figura 2. Perceptimi për sigurinë i të anketuarve .....	9
Figura 3. Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike.....	10
Figura 4. Niveli i kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik të Kosovës .....	13
Figura 5. Perceptimet për problemet themelore me të cilat përballet Kosova aktualisht.....	14
Figura 6. Perceptimet për meritokracinë në sigurimin e punësimit në sektorin publik.....	15
Figura 7. Perceptimet për meritokracinë në sigurimin e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat .	16
Figura 8. Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë.....	19
Figura 9. Perceptimi i kosovarëve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.....	19
Figura 10. Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.....	20
Figura 11. Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.....	21
Figura 12. Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpjeti.....	21
Figura 13. Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat për votim sipas përkatësisë etnike .....	22
Figura 14. Vetëdija e të anketuarve për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër.....	23
Figura 15. Njohuritë e të anketuarve për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër....	24
Figura 16. Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve .....	24
Figura 17. Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve sipas përkatësisë etnike.....	25
Figura 18. Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve sipas përkatësisë etnike.....	23
Figura 19. Burimi i informacionit për COVID-19 .....	24
Figura 20. Burimi i informacionit për COVID-19 sipas përkatësisë etnike të të anketuarve .....	25
Figura 21. Strategjitë për përballimin e ndikimit të COVID-19 në të hyrat e familjeve .....	26
Figura 22. Strategjitë për përballimin e ndikimit të COVID-19 në të hyrat e familjeve sipas përkatësisë etnike .....	26
Figura 23. Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor .....	27
Figura 24. Ndikimi i COVID-19 në mirëqenien ekonomike zbrëthyer sipas përkatësisë etnike .....	28
Figura 25. Ndikimi i COVID-19 në mirëqenien fizike zbrëthyer sipas përkatësisë etnike .....	28
Figura 26. Ndikimi i COVID-19 në shëndetin mendor të të anketuarve sipas përkatësisë etnike .....	29
Figura 27. Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj shpërthimit të COVID-19 .....	29
Figura 28. Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj shpërthimit të COVID-19 zbrëthyer sipas përkatësisë etnike.....	30

## Përmbledhje Ekzekutive

---

Përmbledhja e Pulsit Publik XVIII është raporti me i fundit në serinë e botimeve të ngjashme të botuara në kuadër të projektit Pulsi Publik III. Përmbledhja ofron një pasqyrë të një numri treguesish të matur përmes anketave të Pulsit Publik që hulumtojnë perceptimet e qytetarëve në lidhje me proceset demokratike, kushtet socio-ekonomike dhe sigurinë në Kosovë<sup>1</sup>. Të dhënat dhe treguesit nga anketa zbërthehen sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të detajuara mbi dallimet në perceptime dhe problemet zhvillimore me të cilat përballen grupet e ndryshme etnike dhe grupet e tjera. Në vijim e gjeni përmbledhjen e disa prej gjetjeve kyçe nga anketa e Pulsit Publik XVIII e realizuar në periudhën prill 2020.

Gjetjet e anketës së Pulsit Publik tregojnë një rritje të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve kyçe ekzekutive dhe legjislativë të Kosovës. Nivelet e kënaqshmërisë janë më të lartat të regjistruara nga anketat e Pulsit Publik që nga viti 2010. Kënaqshmëria e regjistruar me punën e ekzekutivit është 60.7%, që përbën një rritje prej 46.3 pikë përqindje nga anketa e nëntorit 2019 kur ishte 14.4%. Për më tepër, niveli i kënaqshmërisë së regjistruar me punën e Kryeministrit është 65.4%, kurse me punën e Kryetares së Kuvendit të Kosovës ka arritur vlerën rekord prej 72.4% kundrejt 20.7% dhe 20.5% të regjistruar në nëntor 2019 dhe maj 2019. Indeksi i Demokratizimit (ID) dhe Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) në 3 pikë (maksimumi). ID-ja është rritur me 0.30 pikë përqindje nga vlera 1.23 që ishte në nëntor 2019, duke arritur një vlerë pozitive prej 1.53. IBE-ja ka rënë me 0.07 pikë nga nëntori 2019 (1.05), duke kapur vlerën prej 0.98 pikësh të matur në prill 2020.

Gjithsej 33.6% e të anketuarve do të ishin të gatshëm të protestojnë për arsye politike, përkatësisht: 34.7% e shqiptarëve të Kosovës, 17.6% e serbëve të Kosovës dhe 24% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Ndërkohë që shumica e serbëve të Kosovës (56%) janë indiferent në lidhje me drejtimin politik të Kosovës, 72% e shqiptarëve të Kosovës dhe 43.1% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës.

Gjetjet tregojnë edhe se shumica e kosovarëve ndihen të sigurt kur janë në rrugë (86.3%). Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat (87.2%) ndihen më të sigurta se meshkujt (85.4%). Pavarësisht nivelit më të ulët të sigurisë të raportuar nga serbët e Kosovës (46.2%), të dhënat tregojnë një rritje të vazhdueshme në numrin e të anketuarve që ndihen të sigurt në krahasim me nëntorin e vitit 2018 (10.4%) dhe me nëntorin e vitit 2019 (27.1%). Anketa e Pulsit Publik hulumtoi edhe problemet kyçe me të cilat përballen Kosova aktualisht. Gjetjet shfaqin trende të ngjashme si anketat e mëparshme duke qenë se të anketuarit raportuan papunësinë (37.2%), korrupsionin (23.5%) dhe varfërinë (15.3%) si tre çështjet themelore që ndikojnë në mirëqenien e tyre sociale. Serbët e Kosovës konsiderojnë se papunësia (38.5%), krimi i organizuar (13.5%), dhe marrëdhëniet ndëretnike (11.5%) janë çështjet kyçe në Kosovë. Gjithsej 80.7% e të anketuarve konsiderojnë së punësimi në institucionet publike në Kosovë nuk bëhet në baza meritore, krahasuar me nëntorin 2019 kur këtë e besonin 77.5% e të anketuarve. Mesatarisht, 20.7% e të anketuarve pohojnë se perceptojnë që korrupsioni të jëtë prezent në institucionet publike dhe ato ndërkombëtare, në Kosovë. Kjo shënon vlerën më të ulët të perceptimit të korrupsionit të regjistruar ndonjëherë nga Pulsi Publik.

---

<sup>1</sup> Për UNDP, referencat për Kosovën do të kuptohet se janë në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999)s

Sa i përket të drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, gjithsej 19.5% e të anketuarve thanë se dinë shumë për këtë temë, 36.8% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 36.9% e të anketuarve thanë se pak dinë për këtë temë. Vetëm 6.8% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Kjo përmbledhje ofron edhe të dhëna për perceptimet e kosovarëve për korrupsionin në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, qëndrimet ndaj votimit, si dhe të dhëna mbi ndikimin e COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor të të anketuarve. UNDP po e mbështet globalisht luftën kundër pandemisë dhe janë duke u zhvilluar ndërhyrje specifike për të adresuar nevojat e vendeve ku punon UNDP-ja. Në Kosovë, UNDP ka ndërmarrë një vlerësim të ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 për të ndihmuar Kosovën dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare në adresimin e problemeve të shkaktuara nga kriza. Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete dhe anketave të mëparshme do jenë publike përmes [Platformës për Vizualizimin e të Dhënave të Pulsit Publik](#).<sup>2</sup>

## Treguesit kyç të Pulsit Publik

Rezultatet e anketës së Pulsit Publik të prillit 2020 tregojnë një rritje dramatike të kënaqshmërisë së qytetarëve me institucionet kyçe të Kosovës krahasuar me anketat e zhvilluara në nëntor dhe maj 2019.

Mesatarisht 42.5% e të anketuarve janë të kënaqur me punën e institucioneve kyçe të Kosovës, që përbën një rritje prej 24.9 pikë përqindje nga anketa e nëntorit 2019 (17.6%) dhe 20.7 pikë përqindje nga anketa e majit 2019 (21.8%). Ky nivel i kënaqshmërisë është më i larti i regjistruar nga Pulsit Publik që nga viti 2010. Konkretisht, kënaqshmëria me punën e Kryetares së Kuvendit është rritur me 51.9 pikë përqindje nga nëntori 2019, kur u regjistrua në vlerën 20.5%, duke arritur në 72.4% në prill 2020. Kënaqshmëria me punën e Kryeministrit ka pësuar rritje nga 20.7% në 65.4%, kurse me punën e qeverisë nga 14.4% në nëntor 2019 në 60.7% në prill 2020.

Rritja në nivelet e kënaqshmërisë evidentohet për shumicën e institucioneve. Për shembull, edhe pse është më i ulët se niveli i matur në nëntor 2018 (36.1%), niveli i kënaqshmërisë me punën e Kuvendit është rritur nga 18.6% në nëntor 2019 në 33.4% në prill 2020. Kënaqshmëria me Presidentin ka rënë me 2.5 pikë përqindje (18.7%) nga nëntori 2019 (21.2%). Nga ana tjetër, kënaqshmëria me punën e gjykatave dhe prokurorisë është rritur nga anketa e nëntorit 2019. Kënaqshmëria me gjykatat qëndron në 24.8%, që është një rritje prej 11.2 pikë përqindje nga nëntori 2019 (13.6%). Kënaqshmëria me prokurorinë u rrit nga 14.2% në nëntor 2019 në 22.3% në prill 2020.

---

<sup>2</sup> Platforma për Vizualizimin e të Dhënave: <http://unkt.org/public-pulse/>


**Tabela 1. Kënaqshmëria e qytetarëve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore në Kosovë**

Treguesit politikë		Mar-15	Sep-15	Apr-16	Oct-16	Oct-17	May-18	Nov-18	May-19	Nov-19	Apr-20	Trendi
Kënaqshmëria me ekzekutivin	Qeveria	18.10%	17.30%	17.80%	20.20%	32.40%	30.00%	31.30%	17.70%	14.40%	60.70%	
	Kryeministri	23.60%	14.60%	18.30%	19.70%	42.30%	33.20%	35.10%	36.50%	20.70%	65.40%	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	19.30%	19.90%	17.30%	18.90%	31.70%	32.90%	36.10%	19.60%	18.60%	33.40%	
	Kryetari i Kuvendit	20.10%	19.80%	24.30%	24.90%	36.00%	31.50%	36.30%	23.60%	20.50%	72.40%	
Kënaqshmëria me Presidentin	Kryetari	30.20%	30.40%	45.70%	25.50%	37.60%	39.10%	38.40%	20.40%	21.20%	18.70%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	17.20%	13.90%	18.40%	22.10%	36.90%	31.20%	37.80%	18.70%	13.60%	24.80%	
	Prokuroria	17.00%	12.80%	16.90%	16.30%	33.10%	29.90%	35.30%	16.40%	14.20%	22.30%	

## Drejtimi politik i Kosovës


Përkundër rritjes së niveleve të kënaqshmërisë me institucionet kyçe, ka pakënaqshmëri me drejtimin politik të Kosovës. Më shumë se gjysma e të anketuarve (62.8%) janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës. Ky nivel i pakënaqshmërisë është rritur me 12.7 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2019. Niveli i kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës arrin vetëm 10.6%, ngjashëm me nëntorin 2019 (10.2%). Gjithsej 19.7% e të anketuarve deklaruan se kanë qëndrim neutral për këtë çështje, që përbën një rënie prej 13.7 pikë përqindje nga anketa e nëntorit 2019, siç tregohet në Figurën 1.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (70.2%) janë më të pakënaqur sesa femrat (66.4%) me drejtimin politik të Kosovës. Në të njëjtën kohë, përqindja e meshkujve që janë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës është pak më e lartë se ajo e femrave: ndërkohë që 11.4% e meshkujve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, vetëm 9.7% e femrave deklaruan se janë të kënaqura ose shumë të kënaqura me drejtimin politik të Kosovës, që përbën një ndryshim nga anketat e nëntorit dhe majit 2019 kur femrat ishin më të kënaqura me drejtimin politik të Kosovës. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se niveli më i lartë i pakënaqshmërisë gjendet tek shqiptarët e Kosovës (72%), të ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (43.1%) dhe nga serbët e Kosovës (42%). Përqindja e të anketuarve neutralë është më e larta në mesin e serbëve të Kosovës (56%), të ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (25.5%) dhe shqiptarët e Kosovës (17.9%). Gjithsej 10.2% e shqiptarëve të Kosovës janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, ndërsa vetëm 2% e serbëve të Kosovës tregojnë të njëjtin nivel kënaqshmërie. Gjithsej 25.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan se janë të kënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës.



**Figura 1. Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës**

Gjithsej 33.6% e kosovarëve janë të gatshëm të marrin pjesë në protesta politike, që përbën një rritje të vogël nga nëntori 2019 (31.3%) dhe një rënie të konsiderueshme nga maji 2019 (42.2%). Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se shqiptarët e Kosovës janë më të gatshëm të protestojnë sesa serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës. Në mënyrë të veçantë, 34.7% e shqiptarëve të Kosovës janë të gatshëm të protestojnë, kundrejt 17.6% të serbëve të Kosovës dhe 24.5% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Të gjitha komunitetet e Kosovës, përveç serbëve të Kosovës, janë më pak të gatshëm të marrin pjesë në protesta politike sesa në maj të vitit 2019 kur gatishmëria e përgjithshme për të protestuar ishte mjaft e lartë: 43.7% e shqiptarëve të Kosovës, 13.3% e serbëve të Kosovës dhe 35% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës.



**Figura 2. Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike**

## Siguria personale

Për të matur perceptimin për sigurinë publike, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur janë në rrugë në aspektin e dhunës dhe krimit potencial. Gjetjet tregojnë nivelet më të larta të sigurisë të regjistruara ndonjëherë nga Pulsi Publik, me 86.3% të të anketuarve që ndihen të sigurt në rrugët e Kosovës. Niveli i dytë më i lartë i sigurisë ishte regjistruar në tetor 2012 kur 84.4% e të anketuarve ishin deklaruar se ndiheshin të sigurt në rrugë. Kjo paraqet një rritje të ndjenjës së sigurisë me 12.3 pikë përqindje nga nëntori 2019 (73.9%) dhe me 15.9 pikë përqindje nga maji 2019.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë një dallim të vogël mes meshkujve dhe femrave, duke qenë se femrat ndihen më të sigurta se meshkujt. Gjithsej 85.4% e meshkujve dhe 87.2% e femrave deklaruan se ndihen të sigurt kur dalin në rrugë. Një prirje e ngjashme e femrave që ndihen më të sigurta se meshkujt kur janë në rrugë u regjistrua edhe në anketën e majit 2019. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime më të mëdha ku 88.2% e shqiptarëve të Kosovës dhe 81.2% e komuniteteve tjera të Kosovës ndihen të sigurt kur janë në rrugë, krahasuar me 46.2% të serbëve të Kosovës. Pavarësisht niveleve të ulëta të sigurisë të raportuara nga serbët e Kosovës, të dhënat tregojnë një rritje të vazhdueshme nga nëntori 2019 (27.1%), maji 2019 (16.2%), nëntori 2018 (10.4%), dhe maji 2018 (4.8%). Një prirje e ngjashme e rritjes së përqindjes së të anketuarve që ndihen të sigurt në rrugë është regjistruar edhe në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës.






Figura 3. Perceptimi i të anketuarve për sigurinë

## Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike

Në përputhje me rritjet të tjera pozitive të shënuara, anketa e opinionit të Pulsit Publik prill 2020 ka regjistruar një rritje të Indeksit të Demokratizimit (ID) dhe një rënie në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike (IBE).<sup>3</sup> Më konkretisht, ID-ja aktuale është 1.53, që përbën nivelin më të lartë të regjistruar nga Pulsi Publik. Kjo shifër sugjeron se më shumë se gjysma e kosovarëve kanë pikëpamje pozitive për proceset demokratike në Kosovë.

Sidoqoftë, mund të vërehet një rënie në IBE, që ka rënë nga 1.05 në 0.98, duke sugjeruar se më shumë se dy të tretat e kosovarëve nuk kanë pikëpamje pozitive për trendet ekonomike në Kosovë. IBE-ja aktuale është e ngjashme me majin 2019 (0.98) dhe ka vlerën më të ulët të regjistruar që nga tetori 2016 (0.94).

<sup>3</sup>ID-ja dhe IBE-ja janë masa të vazhdueshme nga 0 në 3, në të cilat një rezultat nga 0 në 1.5 nënkupton se shumica e popullatës e sheh negativisht demokracinë apo trendet ekonomike, dhe rezultati nga 1.5 në 3 nënkupton se shumica e popullatës e sheh pozitivisht demokratizimin ose trendet ekonomike.




Figura 4. Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike

Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja janë të përbërë nga një numër komponentësh që përdoren për të gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponentë të paraqitur në Tabelën 2. Pyetjet që bien brenda fushëveprimit të këtij indeksi mund të përgjigjen me “Po, plotësisht”, “Po, kryesisht”, “Jo aq shumë”, ose “Aspak”. **Error! Reference source not found.** tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjën me “Po, kryesisht” ose “Po, plotësisht” në nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në rritjen e ID-së, të dhënat nga anketa e opinionit prill 2020 u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme. Gjetjet tregojnë se në të gjithë komponentët e ID-së të shënuara në **Error! Reference source not found.** është parë rritje nga nëntori 2019, dhe disa prej vlerave janë më të lartat e regjistruara ndonjëherë nga Pulsu Publik.

Gjithsej 66.3% e të anketuarve besojnë se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare krahasuar me 62.7% në nëntor 2019 dhe 35.6% në maj 2019. Shumica e kosovarëve (58%) konsiderojnë se Kuvendi e mbikqyrë punën e qeverisë, krahasuar me 38.6% në nëntor 2019. Komponenti i gjyqësorit është më i dobëti mes komponentëve të ID-së; 39.7% të të anketuarve besojnë se gjyqësori është i pavarur në vendimet e tij, që përbën një rritje prej 8.3 pikë përqindje nga nëntori 2019 (31.4%). Gjithsej 69.1% e të anketuarve mendojnë se media gëzon lirinë e shprehjes, duke e bërë këtë komponentin më të vlerësuar pozitivisht të ID-së dhe vlerën më të lartë të regjistruar ndonjëherë nga Pulsu Publik, me një rritje prej 22.4 pikë përqindje nga nëntori 2019. Një rritje prej 16 pikë përqindje (50.7%) nga nëntori 2019 (34.8%) vërehet në perceptimet për rolin e organizatave të shoqërisë civile si monitorues të vërtetë të qeverisë. Sidoqoftë, kjo ende paraqet një rënie prej 6.8 pikë përqindje nga nëntori 2018 kur kjo vlerë ishte 57.5%.

Gjithsej 56.7% dhe 54.9% e të anketuarve - vlerat më të larta të regjistruar ndonjëherë nga Pulsu Publik - mendojnë se institucionet lokale dhe qendrore, respektivisht punojnë sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës. Anketa e nëntorit 2019 regjistroi 29.6% dhe 24.2%. Për më tepër, këto vlera janë rritur me 26.9 pikë përqindje dhe 36.8 pikë përqindje, respektivisht, nga anketa e majit 2019





(29.8% dhe 18.1%). Në pyetjen nëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe nëse ato përputhen me standardet e të drejtave të njeriut, regjistrohet një rritje prej 19.7 pikë përqindje në përgjigjet pozitive (64%) - vlera më e lartë e regjistruar ndonjëherë nga Pulsi Publik. Për fundi, vërehet një rritje e vogël nga nëntori 2019 në përgjigjet në pyetjet nëse proceset demokratike në Kosovë janë krijuar dhe po shkojnë në drejtimin e duhur. Anketa e Pulsi Publik prill 2020 regjistroi 42.5% përgjigje pozitive krahasuar me 33% në nëntor 2019. Sidoqoftë, kjo është një rënie prej 14.7 pikë përqindje nga nëntori 2018 (57.2%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se shumica e serbëve të Kosovës u përgjigjën negativisht në këto pyetje, me “aspak” dhe “jo aq shumë”.

**Tabela 2. Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së**

Po Kryesisht dhe Po plotësisht	15-Mar	15-Sep	16-Apr	16-Oct	17-Oct	18-May	18-Nov	19-May	19-Nov	20-Apr	Trendi
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	26.20%	23.00%	30.30%	28.00%	44.60%	50.90%	53.70%	35.60%	62.73%	66.30%	
A e monitorin Kuvendi performancën e qeverisë?	21.20%	21.80%	26.60%	30.80%	36.10%	46.70%	48.30%	38.10%	38.61%	58.00%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	13.60%	17.60%	21.00%	21.60%	31.20%	43.60%	46.00%	21.50%	31.48%	39.70%	
A gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes?	35.50%	46.50%	47.30%	42.30%	52.50%	52.80%	59.10%	45.60%	46.66%	69.10%	
A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	19.50%	23.10%	32.10%	30.10%	34.30%	48.30%	57.50%	32.60%	34.79%	50.70%	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	23.30%	27.20%	28.90%	30.40%	34.00%	50.20%	49.20%	29.80%	29.62%	56.70%	
A funksionon qeverisa e Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	11.80%	15.50%	18.90%	17.90%	24.70%	39.90%	37.50%	18.10%	24.23%	54.90%	
A janë kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	23.50%	19.80%	31.70%	31.80%	41.40%	53.40%	60.50%	33.40%	40.30%	64.00%	
Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt të ardhmes, a pranonin se proceset demokratike në Kosovë janë vendosur dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?	17.30%	15.40%	23.10%	23.80%	29.70%	46.90%	57.20%	22.40%	33.01%	42.50%	

Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e IBE-së, përgjigjet pozitive të komponentëve të IBE-së u krahasuan me ato të mbledhura në anketat e mëparshme të opinionit, siç tregohet në Tabelën 3. Përgjigjet e mundshme për pyetjet që kanë të bëjnë me IBE-në janë “të favorshme”, “jo të favorshme” dhe “neutrale”. Vetëm 14.2% e të anketuarve kanë pritshmëri të favorshme në lidhje me të hyrat totale të familjes brenda gjashtë muajve, duke shënuar një rritje prej 0.5 pikë përqindje nga maji 2019 (13.7%). Vetëm 8.2% e të anketuarve i shohin në mënyrë të favorshme kushtet për të bërë biznes në Kosovë - një rënie nga vlera prej 9.1% në nëntor 2019, por rritje nga maji 2019 (5.5%). Në mënyrë të ngjashme, vetëm 6.6% e të anketuarve i shohin në mënyrë të favorshme kushtet aktuale të punësimit, çka përbën një rënie nga vlera prej 7.4% në nëntor 2019, dhe një rritje nga maji 2019 (5.8%). Për fundi, 11.6% e të gjithë të anketuarve nga anketa e opinionit prill 2020 i shohin në mënyrë të favorshme kushtet e punësimit në gjashtë muajt e ardhshëm, që përbën një rënie nga nëntori 2019 dhe një rritje nga niveli më i ulët i besimit të regjistruar ndonjëherë nga Pulsi Publik në maj 2019 (4.6%). Për dallim nga ID-ja, komponentët e IBE-së sugjerojnë se mbi dy të tretat e kosovarëve kanë pikëpamje mjaft pesimiste për ekonominë.

**Tabela 3. Analiza e tendencave të komponentëve të IBE-së**

I favorshëm	15-Mar	15-Sep	16-Apr	16-Oct	17-Oct	18-May	18-Nov	19-May	19-Nov	20-Apr	Trendi
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga	15.10%	15.90%	23.40%	18.00%	22.40%	19.90%	18.80%	11.60%	13.70%	14.20%	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale të biznesit	8.10%	8.30%	14.40%	13.10%	17.90%	18.50%	16.70%	5.50%	9.10%	8.20%	
Cili është vlerësimi juaj për gjendjen aktuale të punësimit??	5.00%	6.80%	10.30%	7.70%	17.10%	15.40%	15.90%	5.80%	7.40%	6.60%	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot?	6.00%	8.00%	14.00%	10.70%	18.70%	17.80%	23.30%	4.60%	12.00%	11.60%	

## Drejtimi Ekonomik

Vetëm 10.7% e të anketuarve janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, çka përbën një rritje nga vlera 5.9% e regjistruar në nëntor 2019 dhe vlera 10.4% e regjistruar në maj 2019, por një rënie nga vlera 12.3% e regjistruar në nëntor 2018.

Ndërkohë që 61.2% e të anketuarve janë shumë të pakënaqur ose të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, 28.1% nuk janë as të kënaqur as të pakënaqur. Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë tregojnë se kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës midis femrave dhe meshkujve është afërsisht e njëjtë: 10.5% e femrave janë të kënaqura ose shumë të kënaqura, dhe 10.7% e meshkujve janë të kënaqur dhe shumë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Ne anen tjetër, 62.1% e meshkujve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, kundrejt 59.4% të femrave që ndihen njësoj. Ndërkohë që 26.6% e meshkujve dhe 29.2% e femrave janë neutrale në lidhje me këtë çështje, një përqindje e papërfillshme e të anketuarve nuk e di ose nuk ka pranuar t'i përgjigjet pyetjes. Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike sugjerojnë se serbët e Kosovës janë më pak të pakënaqur (54.2%) sesa shqiptarët e Kosovës (61.5%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (58.9%). Në të njëjtën kohë, vetëm 2.1% e serbëve të Kosovës raportuan kënaqshmëri me drejtimin ekonomik të Kosovës, krahasuar me 11.2% të shqiptarëve të Kosovës dhe 7.8% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës.





Figura 5. Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës

## Problemet themelore me të cilat përballet Kosova aktualisht

Një përqindje e madhe e të anketuarve vazhdojnë të identifikojnë papunësinë, korrupsionin dhe varfërinë si tre problemet themelore me të cilat përballet aktualisht Kosova. Problemi më i madh për 37.2% të të anketuarve është papunësia, e ndjekur nga korrupsioni (23.5%) dhe varfëria (15.3%). Prirje të ngjashme janë vërejtur në nëntor 2019, kur papunësia (31.2%), korrupsioni (19.6%) dhe varfëria (10.5%) u identifikuan si tre problemet themelore me të cilat përballet Kosova. Përveç vitit 2017, papunësia, korrupsioni dhe varfëria janë renditur vazhdimisht si tre problemet kryesore dhe themelore me të cilat përballet Kosova. Gjetjet e tjera tregojnë se 2.4% e të anketuarve konsiderojnë se çmimet e artikujve të domosdoshëm janë problem themelor, 2.1% konsiderojnë krimin e organizuar, dhe 1.8% e të anketuarve konsiderojnë se probleme themelore janë ekonomia informale dhe problemet sociale. Gjithsej 1.4% e të anketuarve konsiderojnë se kujdesi shëndetësor është çështja më e ngutshme në Kosovë.

Ndërkohë që anketa e opinionit prill 2020 nuk shënon ndonjë dallim gjinor mes opinionëve të femrave dhe meshkujve mbi tre problemet themelore, të dhënat e zërthyer sipas gjinisë tregojnë se femrat (39.3%) janë më të shqetësuara sesa meshkujt (35.6%) për papunësinë. Megjithatë, meshkujt (27.2%) janë më të shqetësuar sesa femrat (19.9%) për korrupsionin. Për fundi, femrat janë pak më të shqetësuara për varfërinë (15.9%) sesa meshkujt (15%).

Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallimet në renditjen e problemeve themelore ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera të Kosovës nga njëra anë, dhe serbëve të Kosovës nga ana tjetër. Shqiptarët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës kanë renditur papunësinë, korrupsionin dhe varfërinë si tre problemet themelore me të cilat përballet Kosova aktualisht. Për dallim, serbët e Kosovës konsiderojnë se papunësia (38.5%), pasuar nga krimi i organizuar (13.5%), dhe marrëdhëniet ndëretnike (11.5%) janë çështjet më të mëdha në Kosovë.



**Figura 6.** Perceptimet për problemet themelore me të cilat përballet Kosova aktualisht

## Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat

Anketa e Pulsit Publik prill 2020 tregon se 19.5% e të anketuarve konsiderojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore dhe 80.7% mendojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Këto gjetje kanë shumë pak dallim nga anketa e nëntorit 2019 kur 22.5% e të anketuarve konsideronin se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore dhe 77.5% konsideronin se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Sipas të anketuarve, faktorët kryesorë jo meritore për tu punësuar në sektorin publik janë: lidhjet familjare (30.8%), lidhja partiake (30.4%), ryshfeti (13.8%), miqtë dhe, në një masë më të vogël, pamja fizike. Vetëm 19.5% besojnë se arsimi, aftësimi profesional dhe përvoja profesionale janë faktorë të rëndësishëm për tu punësuar në sektorin publik. Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë dallim të vogël në perceptimet e meshkujve dhe femrave në lidhje me sigurimin e punësimit në sektorin publik. Megjithatë, të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime ndërmjet perceptimeve të komuniteteve të ndryshme. Për shembull, ndërkohë që vetëm 18.1% e shqiptarëve të Kosovës dhe 31.4% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan se përvoja profesionale, aftësimi profesional dhe arsimimi janë faktorë të rëndësishëm për të siguruar punësim, të njëjtën gjë e besojnë 38% e serbëve të Kosovës.





Figura 7. Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik

Ndryshe nga perceptimi për punësimin në sektorin publik, 41.1% e të anketuarve e konsiderojnë se përvojën profesionale, arsimin dhe formimin profesional si faktorë të rëndësishme për t'u punësuar në sektorin privat. Gjithsej 55.9% e të anketuarve besojnë se punësimi në sektorin privat nuk arrihet në bazë të meritave. Të anketuarit identifikuan faktorët e mëposhtëm jo meritore t'u punësuar në sektorin privat: lidhjet familjare (30%), miqtë (14.9%), rryshfeti (7.2%), lidhja partiake (2.8%) dhe, në një masë më të vogël, pamja fizike (0.7 %) dhe gjinia (0.3%).

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë dhe sipas përkatësisë etnike nuk tregojnë dallime të mëdha mes të anketuarve të komuniteteve të ndryshme etnike në lidhje me meritokracinë në sektorin privat të Kosovës. Për shembull, 42.1% e meshkujve dhe 40.1% e femrave besojnë se meritokracia është faktor i rëndësishëm për t'u punësuar në sektorin privat. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se 40.8% e shqiptarëve të Kosovës, 45.3% e serbëve të Kosovës, dhe 43.3% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, besojnë se faktorët meritore, si përvoja profesionale, arsimimi dhe aftësimi profesional, janë çelësi për gjetjen e një pune në sektorin privat në Kosovë.



**Figura 8.** Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat

## Korrupsioni në shkallë të gjerë

Mesatarisht 20.7% e anketuarve pohojnë se perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Kjo vlerë paraqet një rënie prej 13.7 pikë përqindje nga nëntori 2019 (34.4%) dhe 9.4% nga maji 2019 (30.1%), siç tregohet në Tabelën 4. Në të njëjtën kohë, kjo është vlera më e ulët e regjistruar ndonjëherë nga Puls i Publik për perceptimin e korrupsionit në shkallë të gjerë.




Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë luhaten nga vlera më e ulët prej 5.5% të të anketuarve që pohojnë se është i përhapur në organizatat ndërkombëtare deri tek vlera më e lartë prej 37.9% e të anketuarve që pohojnë se është i përhapur në Postën dhe Telekomin e Kosovës (PTK). Ndryshimet më të mëdha pozitive në perceptime janë vërejtur në institucionet e mëposhtme: Administrata Tatimore e Kosovës (18.9% krahasuar me 42.2% në nëntor 2019), gjykatat (24.5% krahasuar me 42% në nëntor 2019), dhe kujdesi shëndetësor (11% krahasuar me 33.4% në nëntor 2019). PTK (37.9%), Agjencia Kosovare e Privatizimit (36.6%) dhe Sektori i Energjisë Elektrike dhe Furnizimit (KEK dhe KEDS) (27.3%) mbeten tre institucionet që kryesojnë për nivelin më të lartë të korrupsionit në shkallë të gjerë të perceptuar. Institucionet me vlerat më të ulëta të korrupsionit në shkallë të gjerë të perceptuar janë organizatat ndërkombëtare (5.5%), Policia e Kosovës (9.8%), dhe kujdesi shëndetësor (11%). Vlen të përmendet se perceptimi për korrupsionin në disa institucione ka parë ndryshime të konsiderueshme ndër vite. Për shembull, perceptimi për praninë e korrupsionit në kujdesin shëndetësor ka rënë ndjeshëm nga nëntori 2015 (56.2%) në prill 2020 (11%). Për më tepër, edhe për komunat është parë një rënie e vazhdueshme e perceptimit për korrupsionin: nga 40.2% në tetor 2016 në 13.3% në prill 2020. Së fundi, edhe tek administrata qendrore është parë një ulje e perceptimit për korrupsionin nga 49.2% në tetor 2016 në 36.7% në maj 2019 dhe 20.8% në prill 2020.

**Tabela 4. Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë**

	Mar-15	Sep-15	Apr-16	Oct-16	Oct-17	May-18	Nov-18	May-19	Nov-19	Apr-20	Trendi
Shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare)	52.60%	51.50%	37.90%	49.70%	25.50%	32.50%	25.70%	25.10%	33.40%	11%	
Sektori Energjisë Elektrike dhe furnizimit (KEK dhe KEDS)	44.70%	35.60%	31.10%	31.40%	20.50%	33.00%	31.30%	40.70%	38.90%	27.30%	
Gjykatat	42.90%	46.90%	42.30%	49.30%	24.90%	38.60%	29.10%	30.70%	42.00%	24.50%	
Doganat	38.70%	41.30%	32.30%	45.20%	22.70%	39.10%	31.40%	29.30%	41.40%	30.60%	
Administrata qendrore/qeveria	38.50%	36.00%	36.60%	49.20%	30.70%	34.70%	28.40%	36.70%	35.30%	20.80%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	37.10%	38.30%	39.20%	45.70%	24.90%	34.50%	29.80%	40.70%	48.10%	36.60%	
Komunat (qeverisja lokale)	33.80%	28.60%	30.00%	40.20%	25.50%	29.00%	26.40%	25.80%	29.80%	13.30%	
Arsimi (shkollat, Universiteti)	29.30%	29.00%	17.50%	31.00%	16.30%	26.20%	19.90%	20.70%	26.10%	13.60%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)	28.10%	25.00%	18.20%	32.50%	17.40%	28.90%	25.40%	35.30%	42.20%	18.90%	
PTK	25.90%	25.20%	18.40%	29.60%	17.00%	27.80%	25.60%	44.20%	40.80%	37.90%	
Bankat	24.30%	23.30%	23.10%	24.40%	13.10%	27.30%	26.10%	33.80%	34.10%	18.90%	
Organizatrat ndërkombëtare	20.40%	22.90%	16.00%	28.00%	10.80%	24.50%	10.70%	19.50%	23.60%	5.50%	
Policinë e Kosovës (PK)	20.40%	19.00%	13.60%	21.10%	14.90%	25.70%	21.60%	17.00%	20.70%	9.80%	


Për të kuptuar se çka ndikon në formimin e perceptimeve për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, të anketuarit u pyetën për arsyt e vlerësimit të tyre për shtrirjen e korrupsionit. Ngjashëm me anketat e tjera në të kaluarën, gjetjet tregojnë se shumica e të anketuarve (52.7%) i kanë formuar mendimet e tyre përmes mediave të shkruara dhe elektronike, siç ilustron në figurën 5. Gjithsej 33.5% e të anketuarve deklaruan se bisedat me të afërmit dhe miqtë formojnë bazën e mendimeve të tyre në lidhje me shtrirjen e korrupsionit, ndërsa 13.1% e të anketuarve pohuan se i kanë formuar mendimet e tyre bazuar në përvojat personale, përkatësisht atyre iu janë kërkuat para, dhurata ose favore të tjera në këmbim të shërbimeve të caktuara.



**Figura 9.** Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre të shtrirjes së korrupsionit në Kosovë


## Qëndrimet kundrejt votimit

Anketa e Pulsit Publik hulumtoi edhe qëndrimet ndaj votimit të qytetarëve të Kosovës. Qëndrimet ndaj votimit kanë ndryshuar dukshëm duke theksuar ndjenjën e fuqizimit të qytetarëve përballë politikës në Kosovë. Në pyetjen nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, një numër shumë i madh i të anketuarve (46.7%) deklaruan se vota e tyre mund të sjellë ndryshime, krahasuar me 35.5% në nëntor 2019 dhe 16.8% në maj 2019. Vetëm 26.8% konsiderojnë se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, përkundrazi 49% në maj 2019, 46% në nëntor 2018 dhe 43% në maj 2018. Gjithsej 24% konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në një farë mase, ndërsa vetëm 2.4% nuk e dinë nëse vota e tyre mund të sjellë ndryshime.



**Figura 10.** Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë


Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat janë më skeptike sesa meshkujt kur është fjala për ndikimin e votës së tyre. Ndërkohë që 49.2% e meshkujve konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 44.3% e femrave mendojnë të njëjtën gjë.



**Figura 11. Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë**


Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme në besimin në zgjedhje si një mekanizëm për të sjellë ndryshime në Kosovë. Vetëm 7.6% e serbëve të Kosovës (3.8% në maj 2019) konsiderojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë, përkundrajt 48.4% të shqiptarëve të Kosovës dhe 35% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës që besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshimet në Kosovë. Ndërkohë që 61% e serbëve të Kosovës nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime, njëjtë mendojnë 25.3% e shqiptarëve të Kosovës dhe 36.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës.

Përqindja aktuale e serbëve të Kosovës që nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime është e ngjashme me atë nga nëntori 2018 (61.5%) dhe dyfishi i asaj të regjistruar në maj 2019 dhe nëntor 2019 (31.9% dhe 34% respektivisht). Të gjitha grupet etnike besojnë në mënyrë të ngjashme për mundësinë që votat e tyre mund të sjellin ndryshime në një farë mase, përkatësisht 24.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 22.4% e serbëve të Kosovës dhe 24.2% e shqiptarëve të Kosovës.



**Figura 12.** Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë


Anketa e Pulsit Publik hulumtoi edhe për gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e tyre për votim. Gjetjet tregojnë se 70.2% e të anketuarve (krahasuar me 62% në nëntor 2019 dhe 73.5% në maj 2019) do të votonin për një parti të caktuar politike ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin në të ardhmen e afërt. Ndërkohë që 13.9% e të anketuarve nuk kanë pasur ndonjë preferencë politike, 7.4% e të anketuarve thanë se nuk do të votonin (7.8% në nëntor 2019 dhe 11.4% në maj 2019), dhe 8.7% nuk iu përgjigjën pyetjes.



**Figura 13.** Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore mbahen së shpejti.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se nuk ka dallime të mëdha mes meshkujve dhe femrave në lidhje me gjasat që të votojnë nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti (84.4% meshkujt, 84% femrat). Megjithatë, të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë


se më shumë serbë do të votonin tani sesa gjashtë muaj më parë: 68.1% e serbëve të Kosovës do të votonin tani, krahasuar me 40.4% në nëntor 2019 dhe 32.7% në maj 2019. Gjithsej 69.8% e shqiptarëve të Kosovës do të votonin, si dhe 71% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Gjithsej 14.2% e shqiptarëve të Kosovës, 12.4% e serbëve të Kosovës, dhe 6.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës nuk kishin preferenca politike, ndërsa 7.3% e shqiptarëve të Kosovës, 13.8% e serbëve të Kosovës, dhe 5.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan se nuk do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti.



**Figura 14.** Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike


## Mjedisi

Vetëdijesimi i publikut për nevojën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm është kyç për politika që nxisin një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Të anketuarit u pyetën për njohuritë e tyre në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 19.5% thanë se dinë shumë për këtë temë, 36.8% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 36.9% e të anketuarve thënë se pak dinë për këtë temë. Vetëm 6.8% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Duke parë trendet, rezultatet tregojnë se përqindja e njerëzve që pohuan se dinë shumë rreth kësaj teme (19.5%) është rritur pak nga 12.8% në nëntor 2019 dhe 10.6% në maj 2019.




**Figura 15.** Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime thelbësore mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë në lidhje me vetëdijesimin e tyre për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 14.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 19% e serbëve të Kosovës dhe vetëm 6% e shqiptarëve të Kosovës deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje, që përbën një rënie në të tre grupet nga të dhënat e nëntorit 2019 (27.2%, 26.7%, dhe 21.5% përkatësisht). Dallimi më i madh mes nëntorit 2019 (21.7%) dhe majit 2020 (6%) është rënia e numrit të shqiptarëve të Kosovës të cilët nuk kanë njohuri për temën. Serbët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri për temën (19%) ose që kanë pak njohuri për të drejtën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm (42.9%). Shqiptarët e Kosovës përbëjnë pjesën më të madhe të të anketuarve (36.9%) që kanë njohuri mesatare për të drejtën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Shqiptarët e Kosovës udhëheqin edhe në njohuritë e shumta për këtë çështje (20.6%), të ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (12.5%) dhe serbët e Kosovës (10%).



**Figura 16.** Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zërthyera sipas përkatësisë etnike

Pyetja e dytë për mjedisin ishte e lidhur me vetëdijesimin e të anketuarve rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore për shëndetin e vetes dhe të familjarëve. Ndërkohë që 15.3% e të anketuarve deklaruan se ishin plotësisht të vetëdijshëm për këto kërcënime, 74.2% e të anketuarve deklaruan se kishin pak njohuri ose njohuri mesatare për këto kërcënime, dhe 10.5% deklaruan se nuk kishin njohuri për kërcënimet e mundshme mjedisore për shëndetin e vetes dhe të familjarëve. Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë se 11.1% e femrave dhe 9.9% e meshkujve nuk kanë njohuri për këtë çështje, dhe se femrat kanë më pak njohuri se meshkujt (2.4 pikë përqindje). Treguesit e tjerë nuk tregojnë dallime domethënëse midis meshkujve dhe femrave në njohuritë e tyre mbi kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre ose të familjarëve të tyre.



**Figura 17.** Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve



Siç shihet në Figurën 18, të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike nxjerrin në pah dallimet mes grupeve etnike në lidhje me kërcënimet e mundshme mjedisore për shëndetin e vetes dhe të familjarëve. Gjithsej 23.3% e serbëve të Kosovës, 21.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, dhe 9.4% e shqiptarëve të Kosovës, deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje. Dallimi më i madh mes nëntorit 2019 (23.9%) dhe prill 2020 (9.4%) është rënia me 14.5 pikë përqindje në përqindjen e shqiptarëve të Kosovës të cilët nuk kanë njohuri për temën. Serbët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri (23.3%) ose kanë pak njohuri (48.1%) për temën. Për më tepër, shqiptarët e Kosovës përbëjnë pjesën më të madhe të të anketuarve (34.9%) që kanë njohuri mesatare rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore për shëndetin e vetes dhe të familjarëve. Për fundi, shqiptarët e Kosovës udhëheqin në njohuritë e shumta në lidhje me këtë çështje (16%), ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (8%) dhe serbët e Kosovës (7.6%).





Figura 18. Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike

## COVID 19

Ky botim i Pulsit Publik përmban edhe pyetje në lidhje me pandeminë COVID-19. Të anketuarit u pyetën së pari për burimet e tyre të informacionit mbi COVID-19. Gjithsej 39.8% e të anketuarve deklaruan se burimi i tyre kryesor i informacionit ishin programet në TV dhe radio, pasuar nga portalet online të lajmeve (24.9%), dhe faqet e rrjeteve sociale (23.1%); pjesa e mbetur ka përdorur burim tjetër informacioni. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se shumica e meshkujve (90.6%) dhe femrat (88.6%) shfrytëzojnë programet në TV dhe radio për të qëndruar të informuar për COVID-19.



**Figura 19. Burimi i informacionit për COVID-19**

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se programet në radio dhe TV janë burimi kryesor i informacionit në lidhje me COVID-19, ndjekur nga lajmet online dhe rrjetet sociale. Gjithsej 50.1% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 41.2% e serbëve të Kosovës dhe 39.3% e shqiptarëve të Kosovës qëndrojnë të informuar në lidhje me COVID-19 nga programet në radio dhe TV. Lajmet online shfrytëzohen nga 25.2% e shqiptarëve të Kosovës, 22.9% e serbëve të Kosovës dhe 18.3% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Për dallim nga shqiptarët e Kosovës (23.3%) dhe serbët e Kosovës (21.6%), pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës i shfrytëzojnë rrjete sociale (21.2%) më shumë sesa lajmet online.




Figura 20. Burimi i informacionit për COVID-19, të dhëna të zërthyerë sipas përkatësisë etnike

Sa u përket strategjive të përdorura për të përballuar ndikimin e COVID-19 në të hyrat e familjes, 41% e të anketuarve thanë se kanë zvogëluar konsumin, 15.3% kanë marrë para borxh dhe 14.1% vazhduan të punojnë për ta përballuar këtë problem. Të dhënat e zërthyerë sipas gjinisë nuk tregojnë dallime të mëdha midis meshkujve dhe femrave në lidhje me strategjitë për të përballuar ndikimin e COVID-19 në të hyrat e familjes. Shumica e meshkujve (53.6%) dhe femrave (55.6%) kanë zvogëluar konsumin për ta përballuar këtë problem.




Figura 21. Strategjitë për përballimin e ndikimit të COVID-19 në të hyrat e familjeve

Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se zvogëlimi i konsumit është strategjia kryesore për të anketuarit e të gjitha komuniteteve etnike për të përballuar ndikimin e COVID-19 në të hyrat e familjes. Këtë strategji e kanë përdorur gjithsej 42.1% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 41.5% e shqiptarëve të Kosovës dhe 28.8% e serbëve të Kosovës. Për dallim nga shqiptarët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës, të anketuarit serbë të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të atyre që kanë vazhduar të shkojnë në punë gjatë krizës (24.8%). Vetëm 15.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 13.4% e shqiptarëve të Kosovës vazhduan të punojnë gjatë kësaj periudhe.






Figura 22. Strategjitë për përballimin e ndikimit të COVID-19 në të hyrat e familjeve, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike

Të anketuarit u pyetën edhe rreth ndikimit të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike, shëndetin fizik dhe shëndetin mendor. Gjithsej 65.9% e të anketuarve deklaruan se COVID-19 ka pasur një ndikim negativ në mirëqenien e tyre ekonomike, 40.7% deklaruan se ndikoi negativisht në shëndetin e tyre fizik, dhe 59% deklaruan se ka pasur ndikim negativ në shëndetin e tyre mendor. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se mirëqenia ekonomike e femrave (68.4%) u prek më shumë sesa ajo e meshkujve (63.6%). Shëndeti mendor i femrave (60.9%) ishte gjithashtu më i prekur sesa ai i meshkujve (57.2%), ndërsa niveli i ndikimit të COVID-19 në shëndetin fizik është i njëjtë si për femrat (40.7%) ashtu edhe për meshkujt (40.6%).




**Figura 23. Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor**

Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se COVID-19 ka ndikuar negativisht në mirëqenien e ekonomike të të gjitha komuniteteve etnike: 65.7% e shqiptarëve dhe serbëve dhe 74.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës raportuan ndikim negativ të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike. Gjithsej 29.9% e shqiptarëve të Kosovës, 27.6% e serbëve të Kosovës dhe 22% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan se nuk kishin asnjë efekt në mirëqenien e tyre ekonomike për shkak të shpërthimit të COVID-19.



**Figura 24. Ndikimi i COVID-19 në mirëqenien ekonomike, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike**

Ndërkohë që shumica e serbëve të Kosovës (69.5%) dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (51.5%) raportuan se COVID-19 ndikoi në shëndetin e tyre fizik, shumica e shqiptarëve të Kosovës (56.5%) raportuan se COVID-19 nuk ndikoi në shëndetin e tyre fizik.



**Figura 25. Ndikimi i COVID-19 në shëndetin fizik, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike**

Shumica e të anketuarve nga të gjitha komunitetet etnike raportuan ndikim negativ të COVID-19 në shëndetin e tyre mendor: 65.2% e serbëve të Kosovës, 64.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 59.2% e shqiptarëve të Kosovës.






Figura 26. Ndikimi i COVID-19 në shëndetin mendor, të dhëna të zërthyera sipas përkatësisë etnike

Të anketuarit u pyetën edhe nëse janë të kënaqur me masat e marra nga institucionet publike të Kosovës për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Shumica e të anketuarve (78.8%) u deklaruan të kënaqur me reagimin e institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga COVID-19. Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat (81.5%) janë më të kënaqura sesa meshkujt (76%) me reagimin e institucioneve publike të Kosovës ndaj krizës së shkaktuar nga COVID-19.



**Figura 27. Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19**

Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se ndërkohë që shumica e shqiptarëve të Kosovës dhe e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës janë të kënaqur me masat e marra nga institucionet e Kosovës për të parandaluar përhapjen e COVID-19, shumica e serbëve të Kosovës janë deklaruar të pakënaqur ose shumë të pakënaqur: 81.1% e shqiptarëve të Kosovës, 77% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, dhe vetëm 26.2% e serbëve të Kosovës janë të kënaqur me masat e marra nga institucionet publike të Kosovës. Gjithsej 53.4% e serbëve të Kosovës, 6.2% e shqiptarëve të Kosovës dhe 5.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës janë të pakënaqur me masat e marra nga institucionet publike të Kosovës për të parandaluar përhapjen e COVID-19.



**Figura 28. Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19, të dhëna të zërthyera sipas përkatësisë etnike**



## Metodologjia

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje janë bazuar në anketën me 1,305 qytetarë të Kosovës mbi moshën 18 vjeçare. Në mostër janë përfshirë të dy gjinitë, meshkuj dhe femra, nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke mbuluar zonat urbane dhe rurale. Konkretisht, mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës (boshnjakë të Kosovës, ashkali të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës). Anketa u bazua në mostër me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta, dhe u zhvilluar në prill 2020. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.

### Peshimi i totaleve të popullatës

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur bëhen llogaritjet për totale, ekipi i Pulsit Publik bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totaleve të popullsisë:

- Shqiptarë të Kosovës: 88%;
- Serbë të Kosovës: 6%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 6%.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej popullsia	Përqindja e popullsisë totale
Shqiptarë të Kosovës	1,616,869	92,93
Serbë të Kosovës	25,532	1.47
Turq të Kosovës	18,738	1.08
Boshnjakë të Kosovës	27,533	1.58
Goranë të Kosovës	10,265	0.59
Romë	8,824	0.51
Ashkali	15,436	0.89
Egjiptas	11,524	0.66
Të tjerët, refuzuan të deklarojnë dhe nuk janë në dispozicion	5,104	0.29
Gjithsej	1,739,825	100.00

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

- Shqiptarë të Kosovës: 93%;
- Serbë të Kosovës: 2%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: 5%.

Megjithatë, marrë parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, u vlerësua se duhet të shtojmë edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës të konsideruar për qëllimet e këtij studimi. Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren në konsideratë këto ndryshime, peshimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

- Shqiptarë të Kosovës: 92%;
- Serbë të Kosovës: 4%;
- Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës: (ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës): 4%.

## Llogaritja e Indekseve

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e bazuar në nivelit e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve me zhvillimet vijuese në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, mbikqyrja e Kuvendit, puna e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse qeveritë lokale punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 do të thotë që asnjë nga anketuarit nuk konsideron që demokratizimi është në rrugën e duhur, ndërkaq rezultati prej 3 do të thotë që të gjithë të anketuarit pajtohen plotësisht se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike është një mesatare e përbërë e cila llogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullatës, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica e popullatës.